

Ne fjalën e rastit ambasadori Dr. Berishaj foli për rrugëtimin e Kosovës deri në shpallje të pavarësisë si dhe për synimet dhe të arriturat e Qeverisë së Kosovës në vendosjen e rendit dhe ligjit, luftës kundër korrupsionit si dhe reformat në drejtësi.

Ambasadori i Republikës së Maqedonisë Veriore Dr. Milaim Fetaj duke shprehur kënaqësinë për të arriturat në Kosovë shtoi se përvjetori i 14 e gjen Kosovën në rrugë të drejtë në reformat që i ka marrë për forcimin e shtetit.

Këtij manifestimi i shtuan madhësinë nxënësit që vijojnë mësimin plotësues në gjuhën shqipe me mësuesen znj. Diana Sahatxhiu.

Nxënësit tonë recituan poezitë e veta, e që me to do të marrin pjesë në gara ndërkombëtare.

#### **25. Pjesëmarrje në përkujtimin e 91 vjetorit të vrasjes së albanologut Dr. Milan Šufflay**

Më datën 19 shkurt, në organizimin e “Družba - Braća Hrvatskog Zmaja”, ambasadori i Kosovës Dr. Martin Berishaj dhe Këshilltari z. Eqrem Haziri vendosën kurorë lulësh në vendin ku 91 vite më parë dora e zezë i mori jetën albanologut, shkencëtarit dhe kroatit e devotshëm Dr. Milan Šufflay, mikut të madh të vërtetës historike për shqiptarët.

Dr. Berishaj në fjalën e rastit kushtuar Dr. Šufflayt, tha se edhe përkundër faktit që me vrasje donin ta shuajnë të vërtetën dhe të këpusin fijet shqiptaro-kroate, nuk arritën se pse edhe sot pas 91 vitesh nga vrasja e tij, Šufflay jeton gjallë në vetëdijen tonë!

Në tubim folën edhe ambasadori i Republikës së Maqedonisë Veriore Dr. Milaim Fetaj dhe deputetja shqiptare znj. Ermina Lekaj Përlaskaj si dhe përfaqësuesja e ambasadës së Shqipërisë, znj. Alma Kasa, Ministër Këshilltar.

#### **26. Ambasadori Dr. Martin Berishaj vizitoi Qendrën për Bashkëpunim të Sigurisë (RACVIAC) në Rakitje, Zagreb**

Të hënë, më 21 shkurt, Ambasadori i Kosovës, Dr. Martin Berishaj, zhvilloi një vizitë kortezie në RACVIAC-Qendra për Bashkëpunim të Sigurisë. Ai u prit nga Drejtori i RACVIAC, z. Jeronim Bazo.

Z. Bazo shfrytëzoi rastin të shprehë mirënjohjen e tij në emër të Organizatës për kontributin dhe mbështetjen e vazhdueshme që Kosova i ka dhënë RACVIAC-ut që nga viti 2014, në drejtim të dërgimit të stafit, pjesëmarrjes në aktivitete dhe mbështetjes së përgjithshme. Gjatë takimit me z. Bazo u diskutua edhe për mundësitë për bashkëpunim në të ardhmen.

#### **27. Ambasadori Dr. Martin Berishaj u prit nga homologu i tij gjerman Dr. Robert Klinke**

Më datën 22 shkurt, ambasadori i Republikës së Kosovës në Kroaci Dr. Martin Berishaj u prit në takim nga homologu i tij gjerman Dr. Robert Klinke në Ambasadën e Republikës së Gjermanisë. Në takim të përzemërt, ambasadori gjerman Dr. Klinke shprehi konsideratat për proceset politike dhe reformat që Qeveria e Kosovës po i ndërmerret në fushën e drejtësisë, luftën kundër korrupsionit si dhe për vendosjen e shtetit të së drejtës në vend, duke inkurajuar se dialogu me Serbinë duhet të japi rezultate për pranim të ndërsjellët, gjë që do të garantonte paqen dhe stabilitetin në Ballkan. Në takim u bisedua gjerësisht rreth gjendjes aktuale në Ukrainë. Ambasadori Dr. Berishaj, shprehi konsideratat dhe respektin ndaj shtetit gjerman dhe për gjithë mbështetjen që i ka dhënë dhe i jep Kosovës në rrugëtimin e saj.

## **28. Takim me përfaqësuesit e kompanisë Sllovene 'DIMAS'**

Më datën 22 shkurt, në hapësirat e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Zagreb, Ambasadori Dr. Martin Berishaj ne Këshilltarin z. Eqrem Haziri, pritën në takim konsultativ me përfaqësuesit e kompanisë sllovene 'DIMAS', z. Janez Tomažin, drejtor dhe z. Tomaž Majce, drejtor teknik i kompanisë.

Qëllimi i takimit ishte vemja e kontakteve fillestare me këtë kompani për të shikuar mundësinë e bashkëpunimit me Kosovën, lidhur me ofertat e prezantuar të produkteve dhe shërbimeve të cilat i ofrojnë në lëmin e mirëmbajtjes së gjeneratorëve/turbinave si dhe transformatorëve energjetik.

Në fillim të diskutimit, Ambasadori Dr. Berishaj, bëri një njoftim të shkurtër për situatën energjetike në Kosovë, duke theksuar se para një muaji kemi pas një havori në njërin prej gjeneratorëve në Bllokun 2, të termoelektranave të Kosovës, si dhe kemi pasur ndihmë në investime nga Qeveria Gjermane në sistemin e transmisionit dhe pavarësimit nga Serbia, lidhur me furnizimin me energji. Ai theksoi se Kosova ka bashkëpunim të mirë me Slloveninë dhe Kroacinë në fushën e energjisë.

Z. Janez Tomažin, tha se si kompani merren me mirëmbajtjen (ESET Menaxhment), dhe përcaktimin e hapave të investimeve, duke përcjellë dhe filtruar vajin në gjeneratorë/turbina dhe transformatorë të elektranave. Ai theksoi se analiza dhe përcjellja e gjendjes së vajit nëpër turbina, pastrimi dhe filtrim i tij nga mbeturinat, uji si dhe duke i shtuar aditiv, që shton jetëgjatësinë e tyre dhe kursen në shpenzimin e panevojshëm në ndërrimin e vajit të turbinave/transformatorëve për një kohë të gjatë. Gjithashtu theksoi se kanë një makinë/instrument me sistem sensori, i cili e përcjellë gjendjen e vajit në turbinë/transformator gjatë procesit të punës, duke shtuar se me këtë makinë mund të përcjellët gjendja e vajit edhe dy vite mbrapa, si dhe gjendja e përgjithshme e turbinave mundet të përcjellët në formë digjitale edhe përmes telefonit.

Ai gjithashtu theksoi se mund të bëjmë shkollimin/aftësimin përmes formës online, ku të njëjtin prezantim mundet që të incizohet dhe për nevoja tuaja ta përdorni në shkollimin/aftësimin e gjeneratave tjera në vazhdimësi. Ne kemi dy makina, të cilat janë të parat në botë, ka shumë sisteme, por janë të parapara për kondicionimin e vajit. Kemi firmën e Zelandës së Re - 'TRAJAN', të cilët e kanë bërë në të njëjtin princip, i cili bënë analizën dhe përcjelljen e gjendjes së vajit. Në fund z. Tomažin theksoi se me këtë sistem të përcjelljes së gjendjes së vajit, aq sa qëndron vaji, aq qëndron edhe turbina ose transformatori, duke e zgjatur jetëgjatësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre psh. nga 30 vit në 70 vite. Sistemi e bënë analizën dhe përcjellë gjendjen e vajit, i cili kur të pastrohet, turbinës mund të i shtohet nga 10% deri 15%, ndërsa deri në 90% mbetet e njëjta.

## **29. Pjesëmarrje në panelin shkencor me temën "Veprimtaria e Politikanit dhe Historianit Milan fisnik Shufflay në fushën e Kulturës Shqiptare"**

Më datën 24 shkurt, në ambientet e Parlamentit Kroat, në Zagreb, me rastin e 91 Vjetorit të vdekjes së Albanologut dhe historianit Milan Shufflay, u mbajt Paneli shkencor me temën "Veprimtaria e Politikanit dhe Historianit Milan fisnik Shufflay në fushën e Kulturës Shqiptare".

Ambasadori Dr. Berishaj propozoi që Instituti albanologjik në Zagreb të mbajë emrin e Dr. Milan Šufflayt

Në mbështetje të znj. Ermina Lekaj Përlaskaj deputete shqiptare në Kroaci, Unioni i Shqiptarëve në Kroaci organizoi simpozium për Dr. Milan Šufflay, në mjediset e Parlamentit kroat, ku morën pjesë, ambasadorët z. Poda dhe z. Fetai, znj. Andreja Metelko Zgombić, Zv. ministre e Punëve të Jashtme e Kroacisë dhe e dërguara e Kryeministrit kroat Andrija Plenković, znj. Zdravka Bušić, nga Këshilli për kroatët jashtë vendit si dhe një numër i konsiderueshëm i deputetëve kroat.

Ambasadori i Republikës së Shqipërisë z Poda, në fjalën e vet duke folur për vlerat e albanologut të madh Dr. Milan Šufflay dhe kontributin e tij të madh për historinë shqiptare theksoi se për nder të tij në dy qytete, në Tiranë dhe Durrës janë pagëzuar rrugët me emrin e tij. Panelistat në këtë simpozium ishin Dr. Martin Berishaj, ambasador i Kosovës, Dr. Željko Bartulović nga Universiteti i Rijekës si dhe Dr. Muhamet Mala nga Universiteti i Prishtinës.

Dr. Berishaj në ligjërimin e tij foli për lidhjet e hershme kroate shqiptare dhe të pathënat për Milan Šufflay duke shtuar se Universiteti i Zagrebit duhet që Institutin albanologjik ta pagëzojë me emrin Dr. Milan Šufflay.

Dr. Željko Bartulović foli për të drejtën zakonore shqiptare dhe ndikimin ilir në hapësirën nga Istra deri në Durrës, kurse Dr. Mala shpjegoi për vlerat historike të shkrimeve të Šufflayt dhe reflekset e atyre shkrimeve në shkencën shqiptare.

### **30. Ambasadori Dr. Martin Berishaj, mori pjesë në ceremoninë e hapjes së Seminarit të Licencimit të Federatës Kroate të Karatesë në Samobor**

Më datën 27 shkurt u mbajt ceremonia e hapjes së Seminarit të Licencimit të Federatës Kroate të Karatesë që është mbajtur në Sallën Sportive në Samobor afër Zagrebit, kampionin botërorë në karate z. Enver Idrizi e nderuan me pllakën e artë, si sportistin e parë që i sollti modalen e artë shtetit Kroat në ditën e shpalljes së pavarësisë së tij.

Në këtë manifestim morën pjesë nga federata botërore e karatesë, ambasadori i Republikës së Kosovës në Kroaci Dr. Martin Berishaj, ambasadori i Republikës së Maqedonisë Veriore Dr. Milaim Fetaj dhe Kryetari i Unionit të Shqiptarëve në Kroaci z. Esat Çollaku me bashkëpunëtorë.

### **31. Në Universitetin e Zagrebit - në Fakultetin e Studimeve Kroate nga sot u shtua edhe lënda Historia e popullit shqiptarë!**

Më datën 28 shkurt, në Universitetin e Zagrebit, në Fakultetin e Studimeve Kroate, u hap moduli, kësaj here si lëndë zgjedhore, Historia e popullit shqiptarë, ku studentëve të historisë do tu ligjërohet për historinë, identitetin dhe kulturën shqiptare.

Kjo lëndë do të ligjërohet nga profesor eminent kroat. Literatura e përzgjedhur dhe përmbajtja e saj premtan shumë.

Në ligjëratën e parë morën pjesë deputetja shqiptare znj. Ermina Lekaj Përlaskaj, si dhe ambasadori i Republikës së Kosovës në Kroaci Dr. Martin Berishaj.

Në fjalën e vet deputetja shqiptare falënderoi ligjëruesit prof. Joško Pavković, prof. Stjepan Čosić dhe paralajmëroi se si ligjërues do të jenë krahas profesorëve kroat edhe profesori Berishaj që tashmë është edhe ambasadori ynë këtu në Kroaci.

Dr. Berishaj, në fjalën e vet shprehi kënaqësinë se do të jenë njëkohësisht edhe ligjërues në këtë lëndë, e që studentëve kroat do tu ofrojë atë pjesë të munguar deri tani, pra, atë të historisë së mendimit politik shqiptarë.

Prof. Čosić i cili njëkohësisht ishte edhe drejtor i Arkivit të Dubrovnikut, shtoi se lënda e historisë shqiptare është ogur i mirë për shkencën kroate në departamentin e historisë kroate dhe se ajo do të pasurohet me dije nga lënda e historisë shqiptare, e cila studentëve do tu hapin rrugë për ta kuptuar sa më mirë dimensionin shqiptarë shkencorë nga Iliria e deri ne ditët e sotme.

Prof. Joško Pavković, studentëve u uroi shtegtim shkencorë në literaturë shteruese lidhur me shqiptarë.

### **32. Pritje e Ambasadori Dr. Martin Berishaj, në Ambasadën e Kanadasë në Republikën e Kroacisë**

Më datën 01 mars, ambasadori i Kosovës Dr. Martin Berishaj, u prit në Ambasadën e Kanadasë në Republikën e Kroacisë. Në këtë pritje ishin edhe ambasadori Mbretërisë së Danimarkës, z. Ole Frijs - Madsen dhe ambasadorja e Republikës së Lituaniës, znj. Jūrate Raguckienė, të cilët u ftuan në drekë pune nga ambasadori i Kanadasë z. Alan Bowman në Rezidencën e Ambasadës Kanadeze në Zagreb.

Lufta në Ukrainë dhe reflekset e sigurisë në Europë si dhe qëndrimi rreth agresionit rus ishte temë e bisedës.

Dr. Berishaj i njoftoi kolegët diplomatë, se Kosova e përcjell me vëmendje të madhe situatën duke shtuar se shteti ynë i është bashkuar sanksioneve të udhëhequra nga SHBA dhe BE, kundër agresionit rus në Ukrainë.

Homologët shprehën mendime të njëjta se Federata Ruse me agresion në Ukrainë ka shkelur të drejtën ndërkombëtare dhe përkrahin luftën e drejtë të popullit të Ukrainës.

### **33. Ministri i Zhvillimit Rajonal z. Fikrim Damka u takua me Ministren për Zhvillim Rajonal dhe Fondet e Bashkimit Evropian në Republikën e Kroacisë znj. Natasha Tramishak**

Më datën 07 mars, Ministri i Zhvillimit Rajonal z. Fikrim Damka sot më datë 07 Mars 2022, realizoi vizitë zyrtare në Zagreb, ku u takua me Ministren për Zhvillim Rajonal dhe Fondet e Bashkimit Evropian në Republikën e Kroacisë znj. Natasha Tramishak.

Qëllimi i takimit ishte zgjerimi i bashkëpunimit në fushën e zhvillimit rajonal, shkëmbimin e përvojave si dhe përgatitjen e programeve për qasje në fondet e BE-së me theks të veçantë programet transnacionale.

Ministri z. Damka falënderoi homologen e tij në Kroaci znj. Tramishak për mirëpritjen, ku theksoi që arsyeja e vizitës së sotme përveç bashkëpunimit dhe dakordimit për një memorandum të bashkëpunimit në një të ardhme të afërt i cili do të nënshkruhet në mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Kroacisë në fushën e Zhvillimit Rajonal është edhe mundësia e pjesëmarrjes së Ministrisë së Zhvillimit Rajonal dhe Fondet e Bashkimit Evropian të Kroacisë në Konferencën për Zhvillim Rajonal e cila organizohet nga MZHR në Prishtinë në datat 24-25 Mars 2022.

Znj. Natasha Tramishak po ashtu falënderoi homologun z. Fikrim Damka e cila shprehi gatishmërinë për bashkëpunim me qëllim të avancimit të zhvillimit socio-ekonomik ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Kroacisë.

Në takimin e përbashkët në mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Kroacisë mori pjesë edhe z. Martin Berisha – Ambasador i Kosovës në Zagreb, i cili mbështeti takimin dhe bashkëpunimin institucional në mes palëve dhe ofroi mbështetjen e tij për koordinimin dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e Zhvillimit Rajonal

Takimi vazhdoi me bashkëbisedimi në mes dy shteteve me diskutimin dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e Zhvillimit Rajonal, shkëmbimi i përvojave dhe mbështetja e Kroacisë në programet transnacionale në kuadër të bashkëpunimit territorial të BE-së, si dhe çështje të tjera me interes të përbashkët.

Ministri z. Damka vizitën zyrtare e realizoi i shoqëruar nga z. Martin Berisha – Ambasador i Kosovës në Kroaci, z. Agon Dobruna - Zëvendësministër, znj. Vjendita Avdiu – Musliu - Drejtoreshë e Departamentit për Planifikim dhe Analiza Socio-Ekonomike, z. Ergin Bunjaku-Këshilltar i Lartë Politik.

#### **34. Ambasadori Dr. Martin Berishaj, takon Ambasadoren e Republikës së Bullgarisë znj. Genka Georgieva**

Më datën 09 mars, Ambasadori i Kosovës Dr. Martin Berishaj, u prit nga ambasadorja e Republikës së Bullgarisë në Kroaci, znj. Genka Georgieva. Marrëdhëniet e shkëlqyera në mes dy shteteve dhe thellimi i mëtejshëm i tyre ishin temë e bisedës, ku homologët u dakorduan se Bullgaria do të mbështesë Kosovën në synimet për forcimin e shtetit të së drejtës, dhe reformat që Kosova ka ndërmarre në fushën e drejtësisë, duke na inkurajuar se dialogu në mes Kosovës dhe Serbisë duhet të rezultojë me njohje reciproke, si kusht për paqe në rajon. Dr. Berishaj e njoftoi ambasadoren znj. Georgieva për pozicionin zyrtarë të Republikës së Kosovës karshi agresionit rus në Ukrainë dhe me Rezolutën e Kuvendit të Kosovës në mbështetje të Ukrainës dhe popullit të saj në rezistencë ndaj agresionit rus, duke kërkuar nga ambasadorja bullgare që shteti i Bullgarisë të mbështesë kërkesat tona që Kosova të behet pjesë e Këshillit të Evropës, anëtarësimin në NATO dhe në BE.

#### **35. Ambasadori i Kosovës Dr. Martin Berishaj priti sot në takim Dr. Neven Budak nga Fakulteti filozofik i Universitetit të Zagrebit, Departamenti i Historisë**

Më datën 10 mars, Ambasadori i Kosovës Dr. Martin Berishaj priti sot në takim Dr. Neven Budak nga Fakulteti filozofik i Universitetit të Zagrebit, Departamenti i Historisë në këtë takim pune, ku u shtrua si temë diskutimi lidhur me bashkëpunim mes Departamenteve të Historisë të Fakultetit filozofik të Universitetit të Prishtinës, në nivelin master me atë të Universitetit të Zagrebit. Dr. Budak nga ana e tij shprehu gatishmërinë se Departamenti i historisë e që e përfaqëson ai, të zyrtarizohet dhe konkretizohet sa më parë. Përndryshe Dr. Budak ishte student i Prof. Zef Mirditës për të cilin ruante kujtimet me të mira. Po ashtu ai shprehi kënaqësinë që në Fakultetin e kroatistikës ka filluar të shpjegohet tashmë Historia e popullit shqiptarë si lëndë e rëndësishme për ta kuptuar sa më drejtë çelësin e studimeve të Ballkanit.

Dr. Berishaj, kolegut të vet i shpaloj synimet që lëndë të tilla të futen në programin mësimorë në Universitetin e Rijekës, dhe të Zarës, për të cilat punohet me intensitet të shtuar. U hodh ideja nga ambasadori Berishaj për themelimin e Institutit për Studime Shqiptare, i cili do të ishte mirë të quhej Dr. Milan Šufflay në Universitetin e Zagrebit, si simbol i bashkëpunimit mes nesh, synim të cilin Dr. Budak e përshëndeti.

#### **36. Ambasadori i Kosovës në Kroaci, Dr. Martin Berishaj mbajti ligjëratë para studentëve në Fakultetin e Kroatistikës në Universitetin e Zagrebit**

Më datën 14 mars, Ambasadori i Kosovës në Kroaci, Prof. Dr. Martin Berishaj mbajti para studentëve të vitit të tretë ligjëratën e parë në lëndën: Historia e popullit shqiptar në Fakultetin e Kroatistikës në Universitetin e Zagrebit. Ligjëratat e tij me titull: “Kriza Lindore dhe çështja shqiptare” zgjoi kureshtjen dhe debat në mesin e studentëve.

Profesor Berishaj në ligjëratën e vetë u fokusua te Kriza Lindore e cila e prishi drejtpeshimin e Ballkanit duke u përqendruar në tendencën e Fuqive të mëdha që donin të vendosin “balancat e reja” në Kongresin e Berlinit.

Zgjerimi horizontal i ndikimit të “depërtimit të butë” i Austro-Hungarisë, hapi trendët konkurruese në mes tyre dhe Italisë e lidhur me trojet shqiptare, si hap i fillimit të lojërave diplomatike të kohës. Dr. Berishaj u ndal në: emancipimin politik të popujve ballkanik posaçërisht popullit shqiptar në fund të shekullit XIX, deri në shpallje të Pavarësisë së Shqipërisë, efektet që Kriza Lindore pati për shqiptarët, duke i dhënë vend të posaçëm Lidhjes së Prizrenit dhe programit të saj politik dhe ushtarak. Ai trajtoi edhe memorandumet nga ai drejtuar Lordit Beaconsfield e deri te Memorandumi i Greçës që i parapriu projektit politik për një Shqipërinë etnike.

Ligjërata u mirëprit dhe zgjoi interesim të madh të studentët.

### **37. Takim me znj. Ana-Maria Žuvan, Zyrtare e Lartë për Kosovën në Ministrinë Kroate të Punëve të Jashtme dhe Europiane**

Më datën 15 mars, në hapësirat e Ambasadës së Republikës së Kosovës, Ambasadori Dr. Martin Berishaj dhe Këshilltari Eqrem Haziri, pritën në takim znj. Ana-Maria Žuvan, Zyrtare e Lartë për Kosovën në Ministrinë Kroate të Punëve të Jashtme dhe Europiane.

Temat e bashkëbisedimit me znj. Žuvan ishin: diskutimi lidhur me marrëdhëniet e shkëlqyera në mes dy shteteve, vazhdimi i bashkëpunimit dhe thellimi i tyre, me qëllim të krijimit të mundësive të përafërimit të bashkëpunimit edhe më të shtuar dhe të përafërt, ndërmjet institucioneve të dyja shteteve dhe popujve tanë.

- Që në fillim znj. Žuvan, pasi shprehu falënderimet për pritjen, tha se Kosova shumë dinamike me ngjarje të ndryshme. Ambasadori Dr. Berishaj, duke reflektuar në këtë tha se Kosova si shteti më i Ri në Europë ka një dinamikë të shtuar për të ecur përpara në arritjet e integriteteve Europiane. Ne kemi fqinjën verior dhe ne duhet të jemi funksional dhe dinamik, dhe gjithnjë shprehim vullnet për paqe dhe stabilitet, ndërsa ata ata kanë ambicie jo proporcionale, në raport me rrethanat në Kosovë.

- Ambasadori Dr. Berishaj, theksoi se ne procesin e Mini-Shengenit, ne mund të hymë vetëm si shtet i pavarur. Lidhur me këtë edhe Gjykata Ndërkombëtare e Hagës ka dhënë opinionin dhe ka konstatuar se shpallja e Pavarësisë së Kosovës nuk është në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar. Në këtë aspekt ne jemi të fokusuar dhe kërkojmë përkrahje për ndihmën dhe në njohjen nga pesë shtetet Europiane që nuk e kanë bërë këtë ende. Kemi një qasje më të afërt me Greqinë dhe Spanjën.

- Znj. Žuvan, tha se kemi biseduar lidhur me atë se çka mund të bëjmë me përkrahjen për Spanjen por ata kanë Baskinë dhe Kataloninë, por ne do të angazhohemi që ata të mos bëjnë paralelizëm por distinkcion (dallim).

Në këtë çështje Ambasadori Dr. Berishaj tha se nuk ka parametra të tilla që mund të bëhet paralelizëm. Historikisht Kosova nuk mund të krahasohet me Baskinë, nuk janë kushtet e njëjta si në Spanjë si në Kosovë, atje shteti Spanjoll nuk ka bërë krime e as gjenocide, ndërsa Serbia në Kosovë ka ushtruar dhunë të vazhdueshme, ka bërë krime dhe gjenocid.

- Ne pavarësinë e shohim si proces, Kosova ka pas kufijtë e definuar dhe pranuar që nga Kushtetuta e vitit 1946 e deri me Kushtetutën e vitit 1974, edhe pse nuk ka qenë shtet, ajo i ka pas të gjitha prerogativat e shtetit dhe i është njohur e drejta e vetëvendosjes (1946). Kosova ka popullsinë e vet, territorin dhe institucionet funksionale. Ambasadori Dr. Berishaj shtoi se ne kemi bërë kompromise, me kushtetutë ju kemi rezervuar 10 vende në Kuvendin e Kosovës, dhe pa vullnetin e tyre edhe qeveria nuk mund të formohet, ne këtë e kemi bërë vetëm për të pas shtet, dhe tani ne kërkojmë vetëm reciprocitet.

- Duke u ndërlidhur me këtë znj. Žuvan, tha se edhe ne e kemi këtë problem me kroatët në Vojvodinë.

- Ambasadori tha se lidhur me asociacionin e komunave serbe, ne nuk mundë të ofrojmë asociacion me kompetenca ekzekutive, dhe lidhur me këtë Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka dhënë mendimin se marrëveshja për asociacionin është në kundërshtim me kushtetutën e Kosovës (në 24 nene), dhe nuk mund të zbatohet. Serbët kanë tentuar edhe në Slloveni dhe Kroaci të vendosin një lloj autonomie apo pushteti 'të dytë' duke i quajtur si 'rajon autonom'-(autonomna oblast).

- Ndërlidhur me këtë znj. Žuvan, pyeti se cili është qëndrimi dhe modeli të cilin ju e preferoni?, ndërsa Ambasadori Dr. Berishaj, tha se është shqyrtuar modeli Belg.

Ne ju ofrojmë të drejta pakicave konform standardeve të garantuara ndërkombëtare, në këtë rast edhe pakicës Serbe në Kosovë, duke pas parasysh se ata në përgjithësi nuk përbëjnë më shumë se 4-5% të popullsisë në Kosovë me përbërje pre 95% të popullatës Shqiptare. Popullsia Serbe në Kosovë është shumë e ndikuar nga politika e Beogradit e sidomos e Kishës Serbe e cila ka ndikimin e jashtëzakonshëm në krejt shtetet e Ballkanit Perëndimor.

- Një rëndësi e veçante e bashkëbisedimit në këtë takim ju kushtua pozitës së pakicës Kroate në Kosovë, me theks të posaçëm atyre që jetojnë në Janjevë. Me këtë rast Ambasadori Dr. Berishaj potencoi se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar që pakicës kroate atje të i ofrohen të gjitha ndihmat dhe përkrahja e mundshme për një jetë të dinjitetshme, dhe se për ne ekzistenca e pakicës Kroate në Janjevë është një pasuri shtetërore. Ai tha se këtë e ka potencuar edhe në takimet që i ka pasur me krerët shtetëror këtu në Kroaci dhe ka kërkuar ndihmë dhe përkrahje që atij populli t'i ofrohen kushte ekzistenciale sa ma të mira, e sidomos në ngritjen e mirëqenies ekonomiko-sociale, në infrastrukturë, me theks të veçantë në arsim duke krijuar kushte që ata të shkollohen me plan-programe arsimore kroate.

- Znj. Žuvan tha se ne në Kroaci ju kemi ofruar dhe dhënë të drejta komuniteteve minoritare dhe japim fonde për zhvillimin e aktiviteteve të tyre kombëtare. Ajo theksoi se tani në Janjevë jetojnë 150 pjesëtare komunitetit Kroat, deri sa me regjistrimin e vitit 91 kanë qenë 8.000. Ajo kërkoj përkrahjen për ruajtjen e shtëpive dhe pasurisë së tyre, dhe përmendi se ka informata që ndriçimi publik nuk funksionon në një lagje, që është projekt i financuar nga një organizatë (por pas një kontaktimi të prifut Don Matej, çështja është për vendosjen e kamerave të sigurisë në një pjesë të lagjes, për çka kanë bërë kërkesë MPB). Ajo the se ne në të gjitha takimet e brendshme e diskutojmë çështjen e Kosovës, dhe shikojmë mundësitë ku mund të ofrojmë ndihmën e mundshme!

- Ambasadori Dr. Berishaj, lidhur me këtë tha se ne nuk mund vetëm të themi: kemi marrëdhënie shumë të mira Kosovë-Kroaci ose Kroaci-Kosovë, por na duhet vullnet dhe angazhim për zgjidhjen e të gjitha çështjeve, duke ju ofruar të gjitha mundësitë qytetarëve tanë. Ne kemi probleme me dokumentacionin kadastral, të cilin e ka marr Serbia, ndërsa ne kemi marr disa kopje të këtij dokumentacioni, por nuk mund të them se është i besueshëm, ku mund të dihet se çfarë mund të jetë bërë atje me ate dokumentacion?(duke përmendur se në një takim me ish Presidentin Kroat Tugjman, ai i ka thënë “mos mendoni se do të ju kthejnë ato dokumente në rregull, duhen edhe 100 vjet për të konstatuar vërtetësinë).

- Në fund Ambasadori Dr. Berishaj, potencoi se ne jemi në përgatitje për anëtarësim në Interpol, dhe duhet shikuar mundësinë çka mundë të ndihmoi Kroacia, ndërsa znj. Žuvan tha se duhet të kemi angazhim të dyanshëm “duhet dhënë diç për të marr diçka”!

Gjithashtu u theksua se duhet vazhduar punën komisionet përkatëse të dyja shteteve për përfundimin e procesit të njohjes së patente-shoferëve.

Znj. Žuvan tha se është në proces dhe se ka disa ndryshime në draft-marrëveshjen e mëhershme dhe se në momentin e përfundimit do të ju njoftojmë.

Takimi ishte shumë miqësor dhe përfundoi me pajtimin e dyja palëve se do të punojmë së bashku në realizimin e detyrave në mënyrë që t'i ngrisim edhe më tutje dhe forcojmë marrëdhëniet edhe ashtu të shkëlqyeshme në mes të shteteve tona.

### **38. Takim me Ratko Gjorgjeviç, ekspert i energjetikës/ambientit**

Më datën 16 mars, në hapësirat e Ambasadës së Republikës së Kosovës, u prit z. Ratko Gjorgjeviç, ekspert i energjetikës/ambientit. Në fillim ambasadori Dr. Martin Berishaj, tha se Qeveria e Kosovës ka vendos të bëjë një strategji të re për energjinë. Me këtë strategji nuk është parapa mos shfrytëzohen burimet energjetike te gazit butan/plini/. Gjithashtu nga Qeveria është parapa edhe strategjia e hekurudhave.

Z. Ratko Gjorgjeviç, lidhur me këtë tha se kur fillohet të bëhen strategjia afatgjate zhvillimore, 'nga e ardhmja në të tashmen', duhet filluar me mendimin se çka nuk do të bëhet për 400 vjet!, duke shtuar se ,si ekspertizë' do të kenë angazhim në BeH, Kosovë e Maqedoni Veriore, ndërsa kemi zhvillua strategji zhvillimore edhe në Mal të Zi. Duke vazhduar z. Gjorgjeviç, tha se malet si relief pasuri e një vendi kanë benefite, ato absorbojnë/marrin CO2 dhe lirojnë O2, dhe strategjia për energjinë duhet orientuar në çështjen e ambientit, dhe se tani me financimin nga BB, për strategjitë për energjinë janë në fazë të zhvillimit/hartimit duke angazhuar Gjermaninë.

Amerikanët kanë bërë një studim në Maqedoninë Verior, te financuar nga BB, për shëndetin, duke konstatuar se shëndetësisë kjo i ka kushtuar 500mil dollar, si rezultat i ndotjes së ambientit(duke shtuar se 30% e ndotjes se ambientit vjen nga Kosova-Obiliq)!

Ambasadori Dr. Berishaj, theksoi se janë në fazë zhvillimore dy strategji/projekte, duke shtuar se Gjermania ka ndihmuar me 40 milion euro, dhe se Kosova nuk është ishull, por do të kontribuoi në ruajtjen e ambientit, për këtë me Qeverinë Shqiptare kemi pas 3 takime, e një pre temave të bisedimeve për projekte ishte për gazsjellësin.

Z. Gjorgjeviç tha se lidhur me fondin për strategjinë energjetike dhe ruajtjen e ambientit dhe shëndetësisë, dhe se nafta, gazit butan/plini/, duhet të eliminohen si burime, sikurse edhe thëngjilli.

Europa ne periudhën deri ne 2030 ka parapa të shfrytëzoji 200 miliard euro për projekte energjetike për ruajtjen e ambientit, dhe se do të ketë direktive që do të ndalojnë projektet qe ndotin ambientin.

Nuk do të jetë energjia diellore, do të ketë orientime në strategji dhe projekte të centraleve atomik/bërthamore. Në Amerikë NASA, është duke punuar në 7 projekte, në energjinë diellore, jo solare, por atë llaserike.

Z. Gjorgjeviç tha se nëse mund të marr një kontratë do të shkoi ne Kosovë për të shikuar çfarë duhet bërë, ndërsa do të ju dërgoi një pyetësorë, lidhur me atë se çfarë mund të punoi eksperti?

Ai shtoi se do ti shikoi programet strategjike që janë duke u punuar. Bateritë 3x75, për dy hektarë amerikanët i kanë dhënë për zhvillimet regjionale. Ato janë në përqindje ambientale në gjelbërim 70% deri në 80% dhe se lidhur me këtë ka financa(para), të parapara deri në vitin 2050, në shuma të mëdha, aq sa në mungesë të projekteve mund të mos shpenzohen!

### **39. Takim me myftiu Aziz ef. Hasanoviq në Bashkësinë Islame të Kroacisë**

Më datën 16 mars, në Bashkësinë Islame të Kroacisë, myftiu Aziz ef. Hasanoviq e priti në takim miqësor ambasadorin e Kosovës Prof.Dr. Martin Berishaj me bashkëpunëtor. Myftiu e informoi ambasadorin Prof. Dr. Berishaj për situatën e besimtarëve në Bashkësinë Islame në Kroaci dhe marrëdhëniet e shkëlqyera me institucionet më të larta të shtetit e popullit kroat. Ambasadori i Kosovës, shprehu konsideratat e tij për myftiun ef. Hasanoviq dhe respekt për besimtarët, e në veçanti për shqiptarët e besimit islam, që punojnë dhe jetojnë në shtetin kroat.

Prof. Dr. Berishaj në fjalën e vetë u shpreh për mundësinë e përfshirjes së gjuhës shqipe krahas gjuhëve tjera, në gjimnazin islamik: “Dr. Ahmet Smajloviq” që është në kuadër të Bashkësisë Islame me qendër në Zagreb, si dhe për bashkëjetesën shembullore të bashkësive fetare ndër shqiptarë, e që pa dyshim është rast i rrallë jo vetëm në rajon por edhe më gjerë. Myftiu ef. Hasanoviq u dakordua me fjalët e ambasadorit Dr. Berishaj duke shtuar se ky model i bashkëjetesës ndër shqiptar është pikësynim dhe ndërgjegje kolektive.



#### **40. Dr. Filip Zoriçiq, kryetar i qytetit të Pullës priti në një takim zyrtar Ambasadorin e Kosovës Prof.Dr. Martin Berishaj**

Më datën 18 mars, kryetari i qytetit të Pullës priti në një takim zyrtar Ambasadorin e Kosovës Prof.Dr. Martin Berishaj, i cili ishte një takim shumë miqësor kryetari i Pullës Dr. Zoriçiq shprehu kënaqësinë që e pret ambasadorin e shtetit mik të Kosovës në Kroaci, i cili diplomat tashmë për një kohë të shkurtër e bëri Kosovën të dukshme në hapësirën kroate. Qyteti i Pullës shtoi ai, është i hapur për bashkëpunim me Muzetë dhe Institucionet e trashëgimisë kulturore, si dhe Ministrinë e Kulturës dhe Sportit në Kosovë, e lidhur me projekte të cilat kanë të bëjnë me bartjen e praktikave të vlefshme për rrugëtimin e Kosovës për anëtarësim në UNESCO.

Prof.Dr. Berishaj, për zemërsisht u falënderua për përkujdesjen që qyteti i Pullës bën për komunitetin shqiptar që jeton dhe punon aty, si dhe për mundësinë lidhur me përkrahjen që Dr. Zoriçiq ofron duke shtuar se Ambasada e Kosovës së shpejti do të organizojë vizitë të kryetarëve të: Dubrovnikut, Splitit, Zarës, Pullës dhe Shibenikut në Kosovë. Ambasadori Berishaj u shpreh se Kosova e mirëpret këtë mbështetje, sepse fryma e bashkëpunimit dhe realizimi i iniciativave të tilla ngrit vlerat e trashëgimisë kulturore në Kosovë.

#### **41. Takim në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Republikës së Kroacisë**

Më datën 22 mars, Ambasadori Dr. Martin Berishaj dhe Këshilltari Eqrem Haziri, u pritën në takim nga z. Stribor Kikerec, Drejtor i Përgjithshëm për Europën Juglindore në Ministrinë Kroate të Punëve të Jashtme dhe Evropiane. Në takim ishin edhe z. Tomislav Perić, Këshilltar i Ministrisë të Punëve të Jashtme dhe znj. Ana-Maria Žuvan, Zyrtare e Lartë për Kosovën në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Evropiane.

Në fillim z. Kikerec, pas shprehjes së mirëseardhjes, tha se ishte një ndjenjë e mirë dhe kënaqësi paraqitja e Letrave Kredenciale të Presidentit Kroat kohë më parë nga Ambasadori i Republikës së Kosovës, si një shtet mik i Kroacisë (duke potencuar se ishte prezentë).

Ambasadori Dr. Berishaj, falënderoi për pritjen edhe se ndjehemi mirë në shtetin mik Kroat, duke theksuar se situata në Republikën e Kosovës është stabile dhe e menaxhueshme. Tani duke e ditur se në Republikën e Serbisë janë zgjedhjet në fillim të muajit prill, ne kemi pranuar një letër nga e ashtuquajtura zyra për Kosovën (Petkoviç), të dërguar nëpërmjet OSBE-së, lidhur me lejimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve serbe në Kosovë, në të cilën thuhet se zgjedhjet do të udhëhiqen dhe do të monitorohen nga OSBE. Ne tani kemi edhe rezolutën e Kuvendit të Kosovës lidhur me referendumin e para pak kohe të Serbisë, me të cilën është refuzuar kërkesa për mbajtjen në territorin e shtetit të Kosovës.

Z. Kikerec, duke vazhduar me diskutimin tha se Kroacia në çdo forum ndërkombëtar e përkrah dhe afirmon Kosovën për integritet në NATO, në BE dhe në çdo organizatë të mundshme ndërkombëtare. Sa i përket zgjedhjeve të Serbisë, në komunat me popullsi shumicë serbe në Kosovë, e kuptojmë pozitën tuaj, lidhur me qëndrimet lidhur me këtë, por nuk dëshirojmë që situata të eskalojë. Ju e dini më së miri se si do ta realizoni këtë, por është mirë që qytetarëve të ju mundësohet kjo e drejtë, duke pyetur lidhur me propozimin e Lajçakut, si është qëndrimi i juaj?, njëherit duke shtuar se edhe amerikanët e përkrahin këtë.

Ambasadori Dr. Berishaj, shtoi se ne kemi parasysh propozimit e z. Lajçak, e respektojmë rregullat e të drejtës ndërkombëtare, dhe kemi qëndrimin që zgjedhjet të mbahen përmes vendotimeve në misionet diplomatike dhe konsullor, në këtë rast përmes Zyrës ndërlidhëse të Serbisë në Kosovë, dhe se kemi kërkuar që Serbia të bëjë kërkesë zyrtare drejtuar institucioneve tona, si dhe problemi qëndron edhe në regjistrat zgjedhor, të cilët janë të më hershëm (dhe sigurisht të fryra), nga se është ndryshe me gjendjen në teren, dhe se Serbia si që e dini edhe ju dëshiron në çdo mënyrë të destabilizoi Kosovën.

Z. Kikerec, duke u ndërlidhur me këtë, tha se duke u nisur nga kjo ekziston edhe rreziku i eskalimit të situatës në veri të Kosovës, dhe shtoi se kur është fjala për zgjedhjet që duhet mbahen në një shtet tjetër, është e

nevojshme që ministria e punëve të jashtme e shtetit përkatës të kërkojë në ministrinë e punëve të jashtme të shtetit ku dëshiron të mbahen zgjedhjet edhe për qytetarët me shtetësi të dyfishte, dhe natyrisht kjo kërkesë shqyrtohet nga institucionet përkatëse për tu lejuar ose jo, e që është praktikë të mbahen nëpër përfaqësitë diplomatike dhe konsullore (duke përmendur rastin me Malin e Zi).

Ambasadori Dr. Berishaj, në vazhdim shtoi se Qeveria e Kosovës është e vendosur në vendosjen e shtetit juridik, dhe se kohën e fundit në këtë drejtim organet kompetente kanë ndërmarr aksion në pikat kufitare me qëllim të kontrollimit më të mirë dhe mos lejimit të kalimit të materialeve të ndaluara. Jemi me fat që e kemi prezent anëtarët e NATO-së, përmes prezencës së pjesëtarëve të KFOR-t. Por ne do të jemi të kujdesshëm dhe nuk do të kontribuojmë në eskalimin e situatës, dhe në këtë proces duhet të gjejmë një zgjidhje në zgjedhjeve që do të mbahen. Qëndrimi i jonë është i qartë nuk besoj se do të ketë ndonjë ndryshim edhe në rast të ndonjë kërcënimi a presioni.

Z. Kikerec, në vazhdim pyeti se a është e mundur që zgjedhjet të organizohen sikur herëve tjera, pas rezolutës së Kuvendit?

Ambasadori Dr. Berishaj, duke reflektuar në këtë, e përsëriti se Serbia është drejtuar me letë përmes OSBE, ndërsa këtë letër duhet drejtuar drejtpërdrejt institucioneve të Kosovës, të cilat do e shqyrtonin dhe sipas standardeve ndërkombëtare do t'i lejonin mbajtjen e zgjedhjeve, por nuk dëshirojmë që një trashëgimi si përvojë jo e mirë të lejohet dhe të vazhdojë.

Z. Kikerec, lidhur me këtë tha se i është e qartë dhe e pëlqen, si dhe e impresionon qasja e Qeverisë Kurti, e cila ka një qëndrim shtetëror, dhe përsëritë se Kosova në Kroaci ka një partner që e përkrahë në çdo forum të mundshëm ndërkombëtar. Na është e qartë edhe lista e prioritetëve për mbrojtjen e interesave të shtetit dhe qytetarëve, por në këtë kontekst ka një grup shtetesh që nuk e njohin mirë situatën në Kosovë, prandaj duhet tentuar që me dialog të gjendet një zgjidhje, situatë të cilën dhe miqtë tanë amerikanë e përkrahin dhe nuk ka alternativë tjetër. Serbia është e shkathtë të paraqitet si përkrahëse e dialogut edhe nëse në të vërtetë në forma të ndryshme e pengon atë. Tani me agresionin rus në Ukrainë është vështirësuar situata edhe lidhur me çështjen e anëtarësimit të shteteve aspirantë për UE. Prandaj është më se e nevojshme që të angazhoheni në zgjidhjen e situatës me dialog, e cila duhet të përfundojë me njohjen e Kosovës nga Serbia.

Ambasadori Dr. Berishaj, tha se e kuptojmë se dialogu nuk ka alternativë, dhe jemi të vetëdijshëm për këtë, e respektojmë Lajçakun, por nuk do të ndërrojmë qëndrim edhe nëse na ofrohet ndonjë shpërblim (psh. liberalizimi i vizave), do të mbrojmë qëndrimin për shtetësinë, kushtetutshmërinë, sovranitetin dhe tërësinë territoriale të Kosovës. Ne me qasjen që kemi dëshirojmë të zgjidhim çështjet ndërshtetërore dhe se në takime me diplomatët në Kosovë, ne po ju paraqesim qëndrimet tona për këtë, dhe i njoftojmë vazhdimisht miqtë tanë për pengesat që ata bëjnë, ndërsa Serbia paraqitet se kinse me dialog po i rregullon raportet e brendshme!

Në këtë z. Kikerec tha se është dakord me qëndrimin e Qeverisë së Kosovës dhe se askush nuk e kundërshton qasjen e përkushtuar për ruajtjen e shtetësisë nga brenda dhe e afirmimin në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Në fund Ambasadori Dr. Berishaj, u interesua për situatën në Bosnje dhe Hercegovinë, dhe mundësinë e përkeqësimit atje?

Z. Kikerec, tha se çështja aktuale është e ndërlidhur me reformën zgjedhore, politikisht nuk dëshirojmë ngritjen e tensioneve, por ligji për zgjedhjet në BeH duhet të miratohet në kuadër të reformës, për çka është e interesuar Kroacia. Nuk shohim kërcënime për ndonjë luftë, por ka tensione politike.

Takimi ishte shumë i hapur dhe miqësor, dhe përfundoi me dëshirën dhe kërkesën e mbajtjes së kontakteve të vazhdueshme.

#### **42. Ambasadorin e Kosovës Dr. Martin Berishaj e priti në takim udhëheqësi shpirtërorë i Misionit Katolik Shqiptar në Zagreb, don Kristë Gjergji**

Më datën 23 mars, Misioni Katolik Shqiptarë në Zagreb sivjet festoi 30 vjetorin e themelimit të tij.

Kjo Qendër shqiptare e njohur për organizimin e simpoziumeve të shumta shkencore, nën përkujdesjen e don Ndue Ballabanit që në atë kohë ishte misionar i Misionit. Si rrjedhojë e këtyre aktiviteteve u botuan përmbi 20 libra studimor dhe monografi me shkencëtar shqiptar dhe të huaj. Disa vite më parë këtu u botua revista "Urtia" e cila shquhej si revistë shkencore për kulturën shqiptare, ku u botuan tekste shkencore të Bartlit, Malcolmit, Mirditës, Stipçeviqit dhe shumë të tjerëve. Në kohë të luftës në Kosovë kjo Qendër shqiptare e mbeshketi fuqishëm luftën çlirimtare dhe aspiratat e popullit shqiptarë për liri dhe pavarësi.

Ambasadorin e Kosovës Dr. Martin Berishaj e priti në takim udhëheqësi shpirtërorë i Misionit Katolik Shqiptar në Zagreb, don Kristë Gjergji, i cili e informoi ambasadorin e Kosovës për projektet lidhur me avancimin e komunitetit shqiptarë në Kroaci, duke u përqendruar në projektin lidhur me ndërtimin e qendrës pastorale shqiptare në Zagreb. Qendër kjo që do të përbush nevojat e shqiptarëve që punojnë dhe veprojnë në Kroaci, pa dallim feje. Në fjalën e vet Ambasadori Berishaj e përgëzoi udhëheqësin e Misionit për punën që bën, duke e inkurajuar atë se bashkërenditja e organizimeve kulturore me gjithë komunitetin shqiptarë sikurse deri me tani është rrugë e vetme e cila duhet të ndiqet.

#### **43. Ambasadorin e Kosovës Dr. Martin Berishaj e priti don Kristo Brkiç në Kishën e kroatëve të Janjevës në Dubravë, të Zagrebit**

Më datën 24 mars, përkujdesja e Republikës së Kosovës ndaj komunitetit kroat në Janjevë është obligim i yni. Edhe pse tashmë kroatët e Kosovës janë numerikisht të paktë mbase shumica e tyre janë shpërngulur në Kroaci, ata si të tillë janë dhe do të mbeten urë lidhëse në mes dy vendeve.

Më datën 24 mars, Ambasadorin e Kosovës, Dr. Martin Berishajn e priti don Kristo Brkiç në Kishën e kroatëve të Janjevës në Dubravë, lagje të Zagrebit.

Don Kristo Brkiç e informoi ambasadorin Berishaj se kroatët e Janjevës janë diaspora më e vjetër kroate në botë. E ambasadori Berishaj tha se: qëndrimi ynë për komunitetin kroat në Kosovë është çështje civilizuese e shumicës shqiptare ndaj tyre. Po ashtu e njoftoi se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe e Sportit e Kosovës ka nënshkruar me UNDP-në marrëveshje për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të qendrës së Janjevës duke shtuar se kroatët në Kosovë janë qytetarë të devotshëm të shtetit tonë dhe se do të përpiqemi tu ofrojmë kushte optimale për të jetuar dinjitetshëm ashtu sikurse të gjithë shtetasve tjerë.

#### **44. Takim me z. Krešimir Vlašić - 'AIR PANONIA'**

Më datën 29 mars, në hapësirat e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Zagreb, Ambasadori Dr. Martin Berishaj dhe Këshilltari Eqrem Haziri, pritën në takim z. Krešimir Vlašić, 'AIR PANONIA', kompani e cila vepron në Kroaci që nga viti 1993, dhe veprimtari e së cilës është spërkatja e hapësirave për mbrojtje të sipërfaqeve bujqësore dhe tjera nga insektet/mushkonjat dhe nga rriçrat.

Qëllimi i takimit ishte shikimi i mundësisë së bashkëpunimit me autoritetet Kosovare në lëmin e bujqësisë dhe atë shëndetësore.

Pas mirësearchjes dhe falënderimit për vizitën, Ambasadori Dr. Martin Berishaj, bëri një prezantim të shkurtër, duke theksuar nevojën e bashkëpunimit në këtë drejtim, ndërsa tha se në Kosovë kemi një pjesë të territorit, duke veçuar komunën e Malishevës, ku gjatë verës paraqiten rriçrat, por edhe kemi hapësira në të cilat kemi nevojë për spërkatjen e insekteve/mushkonjave, prandaj edhe mundë të shikojmë mundësitë e mira për bashkëpunim me firmat kroate, duke e theksuar marrëdhëniet shumë të mira në mes shteteve dhe popujve tanë.

Z. Vlašić, i bëri një elaborim të veprimtarisë që ushtron në Kroaci dhe në vendet tjera europiane, duke shtuar se si kompani janë të pajisur me aeroplan bashkëkohor, me të cilët bënë spërkatjen kundër insekteve dhe mushkonjave, në fushën e Sllavonisë dhe maleve në Kroaci, si dhe në hapësira të ndryshme në shtetet tjera. Ai sqaroi se duke u bazuar në standardet e parashikuare, është e preferuar që spërkatjet e fushave në të cilat paraqiten insektet/mushkonjat dhe rriçrat, duhet spërkat në pranverën e hershme, në mënyrë që të jete më e efektshme.

Ambasadori Dr. Berishaj, tha se sa i përket kompanive Kroate ato janë të mirëseardhura dhe për ato janë dyert e hapura në Kosovë, duke kërkuar prezantimin me një elaborim fillestar, në një përshkrim të shkurtër të fushë-veprimtarinë, ndërsa ne do të komunikojmë me institucionet përkatëse kompetente në Kosovë, dhe do të vejmë kontaktet dhe pasi të koordinojmë terminët për realizimin e një vizite tuajën në Kosovë, dhe ju me përfaqësuesit e institucioneve Kosovare do të shikoni mundësitë e bashkëpunimit në këtë lëmi, duke i prezantuar praktikat e mira Kroate.

Po ashtu, Ambasadori Dr. Berishaj, theksoi se ne kemi komunikimin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm edhe në hapjen e linjës së qarkullimit të udhëtarëve dhe mallrave, në lëmin e aerotransportit në mes Zagrebit dhe Prishtinës, kështu që në fund të muajit prill të këtij viti, do të shkojë ministri Kroat i transportit në Kosovë për të diskutua lidhur me vendosjen e kësaj linje.

Takimi përfundoi me shprehjen e kënaqësisë dhe dëshirën e bashkëpunimit, në realizimin e këtij projekti me interes të dyanshëm.

45. Ambasadori i Kosovës Dr. Martin Berishaj e priti në takim ambasadorin e Republikës së Shqipërisë SHTZ Riza Poda

Më datën 29 mars, Ambasadori i Kosovës Dr. Martin Berishaj e priti në takim ambasadorin e Republikës së Shqipërisë SHTZ Riza Poda.

Kjo bisedë vëllazërore u karakterizua me bashkërenditje të aktiviteteve të përbashkëta në shumë fusha me interes për shqiptarët.

Ambasadori Dr. Berishaj e njoftoi homologun e vetë për nismat që ambasada e Republikës së Kosovës i ka marrë në fusha të bashkëpunimit ndër-parlamentar me shtetin kroat si ato: kulturore, arsimore dhe ekonomike.

Synimi i të dy ambasadave është pa dyshim vazhdimi i lidhjeve ekonomike, politike dhe të sigurisë me shtetin kroat.

#### **46. Takim në Parlamentin Kroat, me Grupin Ndër-parlamentar të Miqësisë Kroaci – Kosovë**

Më datën 30 mars, Ambasadori i Kosovës Dr. Martin Berishaj dhe Këshilltari z. Eqrem Haziri, u pritën në takim në Kuvendin e Kroacisë nga Grupi Ndër-parlamentar i Miqësisë Kroaci- Kosovë.

Kreu i Grupit, Ante Bačić, e njoftoi ambasadorin Berishaj me aktivitetet e deritanishme të Grupit dhe prezantoi planin e tij të punës për të ardhmen. Në fjalën e tij, ai theksoi se marrëdhëniet mes dy vendeve janë tradicionalisht miqësore, por se ka ende shumë hapësirë për përmirësim dhe ngritje të mëtejshme, veçanërisht në aspektin ekonomik, bashkëpunimin akademik dhe zhvillimin e sistemeve të mbrojtjes dhe sigurisë.

Ai vazhdoi duke përmendur ndihmën reciproke në mes dy shteteve dhe popujve tanë, dhe theksoi pjesëmarrjen e kosovarëve në luftën Atdhetare të Kroacisë dhe përkrahjen dhe ndihmën e Kosovës me rastin e tërmetit të vitit 2020, në Zagreb, e po ashtu ndihmën e dhënë nga ana e shtetit Kroat me rastin e aksidentit fatkeq të autobusit me shtetas Kosovar, vitin e kaluar në Sllavonski Brod. Ai shtoi se pakica (bashkësia) Shqiptare, si shtetas kroat e meritojnë një kujdes të veçantë, duke shtuar se edhe ushtria Kroate po jep kontributin në ruajtjen e stabilitetit